



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

AUTORITETI KOMBËTAR I VETERINARISË DHE MBROJTJES SË BIMËVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME

### NJOFTIM PËR SHPALLJE VENDE VAKANTE

Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 683, datë 2.9.2020, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve”, Urdhrit Nr. 140, datë 27.10.2023, “Mbi krijimin e komisionit dhe procedurën e konkursit për punonjësit me kontratë”, shpall njoftimin për vende të lira pune në pozicionet:

- **5 Veterinerë Zyrtarë Shërbimi**, pranë Drejtorisë Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Shkodër.

**1 pozicion në Zyrën Vendore Has/Kukës, Njësia Administrative Golaj, Krumë**

**1 pozicion në Zyrën Vendore Tropojë/Kukës, Njësia Administrative Margegaj, Tropojë**

**1 pozicion në Zyrën Vendore Pukë, Njësia Administrative Gjegjan, Pukë**

**1 pozicion në Zyrën Vendore Kukës, Njësia Administrative Kolsh, Shtiqen**

**1 pozicion në Zyrën Vendore Pukë, Njësia Administrative Fushë-Arrëz, Pukë**

- **3 Veterinerë Zyrtarë Shërbimi**, pranë Drejtorisë Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë.

**1 pozicion në Zyrën Vendore Përmet/Gjirokastrë, Njësia Administrative Petran/Piskovë**

**1 pozicion në Zyrën Vendore Vlorë, Njësia Administrative Novoselë**

**1 pozicion në Zyrën Vendore Gjirokastrë, Njësia Administrative Frashër**

- **1 Veterinerë Zyrtarë Shërbimi**, pranë Drejtorisë Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Elbasan.

### **1 Pozicion në Zyrën Vendore Pogradec, Njësia Administrative Proptisht**

Detyrat kryesore për vendet e shpallura janë:

- Identifikimin dhe regjistrimin e fermës e të kafshëve blegtorale dhe lëshimin e certifikatës veterinarë të lëvizjes së kafshëve, sipas rregullores përkatëse.
- Zbatimin praktik të programeve të profilaksisë shtetërore për sëmundjet në kafshë në një ose disa njësi administrative të përcaktuara; zbatimin e masave për kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve infektive në kafshë, në vatrat e shpërthimeve.
- Në rastet e sëmundjeve zoonotike, veterineri zyrtar i shërbimit informon strukturat përkatëse të shëndetit publik dhe institucionin përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

#### **Kandidatët duhet të dorëzojnë:**

- kërkesën për punësim, ku duhet të përcaktojnë pozicionin për të cilin po aplikojnë;
- një kopje të CV-së të përditësuar;
- diplomën "Mjek Veteriner" të noterizuar dhe listën e notave të noterizuar;
- certifikata me kualifikime të ndryshme;
- një kopje të librezës së punës;
- një kopje të ID-së;
- formularin e vetëdeklarimit të gjëndjes gjyqësore (ose *dëshmi penalteti*);
- raportin mjeko - ligjor (*për personat që do të përzgjidhen fitues*);

Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër do të bëhet në adresën e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve ku kandidati do të aplikojë për punësim, ose të skanuara në adresën e e-mail: [info@akvmb.gov.al](mailto:info@akvmb.gov.al)

Dorëzimi i dokumentacionit përbën kusht për kualifikimin e kandidatit në procedurë.

Kërkesat e protokolluara nga kandidatët e interesuar do të pranohen nga data **8.3.2024-22.3.2024**

Pas përfundimit të përzgjedhjes së kandidatëve të kualifikuar do të bëhet njoftimi për intervistën e strukturuar me gojë.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Rolandi Meçaj**

